



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/133  
Datë: 24.02.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/133  
Datë: 24.02.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2016 për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/133  
Datë: 24.02.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 pika 8 të Ligjit Nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej: 2,129,000.00€ në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me 25 (njëzet e pesë) marrëveshjet e mirëkuptimit të nënshkruara nga MAPL dhe kryetarët e komunave për projekte kapitale.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAEA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/133  
Datë: 24.02.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Këshilli Organizativ për Manifestimin gjithë-popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cila do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa më 5, 6 dhe 7 mars, në këtë përbërje:
  - 1.1. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, kryesues;
  - 1.2. Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar;
  - 1.3. Përfaqësues, Komuna e Skenderajt, anëtar;
  - 1.4. Përfaqësues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
  - 1.5. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme, anëtar;
  - 1.6. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme, anëtar.
2. Ftohen që ta dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill Organizativ:
  - 2.1 Zyra e Presidentit, anëtar;
  - 2.2 Kuvendi i Kosovës, anëtar;
  - 2.3 Komuna e Prishtinës, anëtar;
  - 2.4 Organizatat e dala nga Lufta e UÇK-së, anëtar;
  - 2.5 Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar dhe
  - 2.6 Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Për punën e Këshillit Organizativ ndahen mjete financiare në vlerë prej 50,000.00 euro, të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.
4. Mjetet financiare nga pika 3. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 nën kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe barten në Zyrën e Kryeministrit, nën-programi Kabineti i Kryeministrit me kod 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në nën kategoritë ekonomike: 13460 Shërbime kontraktuese tjera, 13450 Shërbime të shtypjes-jo marketing, 13610 Furnizim për Zyre, 13620 Furnizim me ushqim dhe pije-jo dreka zyrtare, 13133 Shpenzime tjera e udhëtimit zyrtar brenda vendit.

5. Obligohet Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 05/133  
Datë: 24.02.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2017, mori:

**V E N D I M**

1. Znj. Edi GUSIA, emërohet Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore.
2. Mandati i të emëruarës nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. E emëruara nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë